

gjatë betejës me forcat serbe në **Glogjan/Glodane**. Pjesëtarë të UÇK-së e kanë çuar në spitalin në Irzniq/Rznić, ku ai ndërroi jetë nga plagët e marra. E kanë varrosur në varrezat e fshatit Shaptej/Šaptelj.

Burimet: deklarata Z.S, FDH-12766; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Bekim (Fazli) Berisha

(15.06.1966, shqiptar nga Graboci/Grabovac, komuna e Pejës/Peć, punëtor turizmi, pjesëtar i UÇK-së)

Bedri (Veli) Shala

(2.06.1969, shqiptar nga Gjergjica/Đurdica, komuna e Gillogocit/Glogovac, pjesëtar i UÇK-së)

Elton (Gëzim) Zherka

(19.08.1977, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Permet (Ilir) Vula

(8.04.1978, shqiptar nga Gjakova/Đakovica, pjesëtar i UÇK-së)

Bekim Berisha, i quajtur *Abeja*, ka qenë pjesëtar i *Legjionit të të Huajve* në Francë. Ka luftuar në Kroaci në anën e ushtrisë kroate. Në mars të vitit 1998, ai aderoi në UÇK.

Bedri Shala i ishte bashkangjitur Lëvizjes Popullore për Çlirimin e Kosovës (LPÇK) në vitin 1984. Për shkak të aktiviteve të tij në këtë lëvizje, policia serbe e ka marr në pyetje shume herë familjen Shala. Shabani, vëllai i Bedriut, ishte dënuar me shtat vjet burgim për shkak të veprimtarisë kundër regjimit serb. Bedriu ishte një nga organizatorët e demonstratave në Gillogoc/Glogovac më 31.01.1990. Më pas, ai shkoi në Danimarkë, e pastaj në Norvegji. Në Kosovë u kthye përmes Shqipërisë, më 6.03.1998, dhe menjëherë aderoi në UÇK. U emërua komandant i shtabit të UÇK-së në Glogjan/Glodane, e pas pak edhe për përgjegjësinë për trajnimin e regrutëve të rinj dhe organizimin e transportimit të armatimeve nga Shqipëria për në rajonin e *Dukagjinit/Dukadini*.

Permet Vula dhe Elton Zherka aderuan në UÇK më 18.04.1998. Prej datës 28. 07.1998, të gjithë ata kanë marrë pjesë

në mbrojtjen e **Junikut/Junik**. Gjatë betejës me forcat serbe, e cila u zhvillua më **10.08.1998**, së pari u plagos Bedri Shala, ndërkaq Bekimi, Eltoni, Permeti si dhe një ushtar me emrin Stilian Hoda, u nisën për t'i dhënë ndihmë mikut dhe bashkëluftëtarit të tyre, por nuk ia arritën sepse të gjithë u qëlluan për vdekje, përpos Stilianit, i cili vetëm u plagos. Edhe plaga e Bedriut ishte vdekjeprurëse. Bedriu, Bekimi, Permeti dhe Eltoni u varrosën së pari në Junik. Për nder të Bedri Shalës, UÇK-ja e ka emërtuar Brigadën e vet të 134 sipas emrit të tij. Pas përfundimit të luftës, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Bedriut në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në fshatin Polac/Poljance. Mbjetjet mortore të Eltonit dhe Permetit janë rivarrosur në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Gjakovë/Đakovica, ndërkaq mbetjet mortore të Bekimit janë rivarrosur në fshatin Shkozë/Škoza. Ai u nderua me gradën e gjeneral-majorit pas vdekje.

Burimet: J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; SHFДУÇK, *Feniksët...* 2, 94-96; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 212, 213, FDH-23857; SHFДУÇK, *Feniksët...* 6, 85-87; SHFДУÇK, *Feniksët...* 2, 87-90.

Gjyke (Ramë Idrizaj) Hajdaraj

(1918, shqiptare nga Shaptej/Šaptelj, komuna e Deçanit/Deçani, tre fëmijë)

Forcat serbe i kanë filluar granatimet e fshatit **Shaptej/Šaptelj** më 8.08.1998. Sulmi ka zgjatur për disa ditë resht. Gjatë tërë kësaj kohe, Gjykja e moshëthyer qëndronte në shtëpi me djalin Asllanin, ndërsa familjarët e tjerë e kishin braktisur fshatin një ditë përpara fillimit të sulmit. Në datën **10.08.1998**, përderisa ajo gjendej në oborr, një predhë e ka qëlluar katin e dytë të shtëpisë së saj. Gjete vdekjen nga ky shpërthim, përderisa djali i saj vetëm u plagos. Po atë ditë, Asllani e ka varrosur të ëmën në një gropë të gëlqeres në oborrin e tij. Në pranverë të vitit 2001, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Gjykes në varrezat lokale.

Burimet: deklarata A.H, FDH-19251; SMIP, *Teroristički...*, III, 913.